Sigurimi i Jetës me Afat i Rinovueshem "On Vita" Kushtet e Përgjithshme të Sigurimit

Përkufizime

'Siguruesi' - shoqëria e sigurimeve SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Sh.A., Tiranë, e autorizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për klasat e sigurimit të Jetës.

'Kontraktues/Policembajtes' - Individi, personi fizik ose juridik i përcaktuar si i tillë në Formular. Gjatë kohës që i Siguruari jeton, dhe në varësi të shënimeve në praktikën përkatëse të Siguruesit, vetëm Kontraktuesi ka të drejtë të ushtrojë të gjithë të drejtat që jep kjo policë ose lejon Siguruesi. Për këtë policë sigurimi Kontraktues/Policembajtes është 'i Siguruari'.

'I Siguruar' - Individi i siguruar sipas këtyre kushteve të sigurimit, në moshën nga 18 vjeç deri në 65 vjeç, nënshtetas të Republikës së Shqipërisë të cilët janë rezident në Shqipëri.

"Përfituesi" - do të jenë vetem Trashëgimtarët Ligjorë të të siguruarit, të përcaktuar si të tillë në Dëshminë e trashëgimisë.

'Policë Sigurimi' - këto Kushte të Përgjithshme, Formulari i Policës dhe çdo shtesë ose ndryshim i mëvonshem miratuar nga Siguruesi. Përfituesi mund të përfitojë përfitim të pagueshëm vetëm në bazë të **një** police "On Vita", pavarësisht numrit të policave në fuqi "On Vita". Në rast se në ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, i siguruari ka në fuqi më shumë se një policë sigurimi "On Vita", për përllogaritjet e përfitimit(et) të pagueshëm do të konsiderohet vetëm një prej tyre - polica me shumë sigurimi më të lartë. Policat e tjera ne fuqi konsiderohen të pavlefshme dhe primi i paguar do i kthehet të Siguruarit/Përfituesit pas zbritjes se shpenzimeve administrative në masën 15% të primit.

'Formular i Policës' - formulari i cili përfshihet dhe është pjesë përbërëse e kësaj Police.

'Ngjarje sigurimi' - ngjarje e ardhshme, e pasigurtë, që është e pavarur nga vullneti i të Siguruarit, që sjell si rrjedhojë të drejtën e Përfituesit për të kërkuar Përfitimin e Pagueshëm. Për efekt të këtij sigurimi, 'ngjarje sigurimi' do të konsiderohet 'humbja e jetës së të Siguruarit brenda periudhës së sigurimit'. Do të zbatohen përjashtimet sipas këtyre Kushteve të Përgjithshme dhe Periudha Fillestare e Pritjes.

'Humbja natyrale e jetes'- humbja e jetes per shkak te semundjes apo keqfunksionit te brendshem te organizmit e cila nuk eshte pasoje e drejtperdrejte e forcave te jashtme. Ajo shkaktohet nga shkaqe natyrale te ndryshme nga aksident, vetvrasje apo vrasje.

'Aksident'- Një ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa vullnetin e të Siguruarit, e identifikueshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të Siguruarin.

'Humbja Aksidentale e Jetës' - humbja e jetës të të siguruarit si rrjedhojë e një aksidenti që ndodh brenda periudhës të sigurimit, humbje jete që ndodh brenda 12 muajsh nga data e këtij aksidenti.

'Shumë sigurimi'- shuma e përfitimit të pagueshëm Përfituesit sipas kësaj Police në rast të humbjes së jetës së të Siguruarit, e cila përcaktohet në Formularin e policës.

'Data e Fillimit të sigurimit' - Data e shënuar si Datë Fillimi në Formularin e Policës së Sigurimit, me kusht që të jetë paguar më parë primi i sigurimit i specifikuar ne Formularin e polices.

'Data e përfundimit' - sipas përcaktimit në Formularin e policës.

'Periudhë fillestare e pritjes' - Periudha kohore në ditë kalendarike nga data e fillimit të sigurimit, gjatë të cilës mbulimet e dhëna nga kjo policë nuk janë të vlefshme, përveç ngjarjeve si rrjedhojë e një aksidenti të ndodhur brenda periudhës së sigurimit.

'Gjendje paraekzistuese' - Çdo gjendje shëndetësore, sëmundje ose komplikacion i saj ose dëmtim, ose plagë që ka ekzistuar para datës së fillimit të sigurimit, pavarësisht nëse i siguruari ka pasur dijeni ose jo.

Mbulimi në sigurim

Në përputhje me përcaktimet në Formularin e policës së sigurimit (pjesa 'Mbulimi në Sigurim') dhe parashikimet e Kushteve të Përgjithshme të sigurimit, kjo policë ofron pagesën e shumës së sigurimit të përcaktuar në Formular në rast të 'Humbjes te jetës së të Siguruarit brenda periudhës së sigurimit'

Përfitimi i pagueshëm

Në varësi të parashikimeve, kushteve e përjashtimeve të Policës, me marrjen dhe miratimin e dokumentacionit të kërkuar, Siguruesi do t'i paguajë Përfituesit shumën e sigurimit si Përfitim të Pagueshëm.

Periudha fillestare e pritjes

90 ditë kalendarike nga data e fillimit të sigurimit.

Përjashtime të Përgjithshme

SIGAL Life nuk do të mbulojë ngjarje që është rrjedhojë direkte ose indirekte e:

- luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes;
- reaksonit bërthamor, rrezatimit bërthamor ose ndotjes radioaktive, pavarësisht nga burimi i tyre;
- epidemisë, pandemisë
- veprimeve keqdashëse të kryera nga përfituesi ose partnerët e tij kundër interesave të të Siguruarit;
- dehjes, përdorimit të tepërt të psikofarmaceutikëve, ilaçeve ose haluçinantëve, abuzimit me substanca apo ilace, qenies së të siguruarit nën efektet e drogave apo alkoolit
- Sindromës së Deficiencës Imunitare të Fituar (AIDS) dhe sëmundjeve të lidhura me të;
- vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje;
- dëmtimeve të shkaktuara vetëvehtes;
- vrasjes;
- pjesëmarrjes së të Siguruarit në veprimtari kriminale, të kundraligjshme, sulme apo veprime e kundërveprime të dhunshme;
- pjesëmarrjes në sporte të rrezikshme si parashutizmi, ngjitjet malore, fluturimit me avionë pa motorr, zhytjeve nënujore, garave sportive motorrike;
- pjesëmarrjes në shërbim ushtarak brenda apo jashtë vendit apo anëtar vullnetar i forcave ushtarake gjatë luftës;
- pjesëmarrjes së të siguruarit në fluturime, përveçse si pasagjer në një avion të licensuar që i përket një shoqërie ajrore;
- ekspozimit të vullnetshëm ndaj rreziqeve të veçanta (përveçse në tentativë për të shpëtuar jetë njerëzore);
- çdo lloji defekti fizik apo mendor ose gjendje shëndetësore ekzistuese përpara datës së fillimit të sigurimit, ose të lidhura me to sipas përcaktimit "Gjendje Paraekzistuese".

Individë që nuk sigurohen

SIGAL Life nuk ofron mbulim në sigurim për:

- individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoia, sindroma organiko-cerebrale;
- individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm, invalid me paaftësi të pjesshme ose të plotë;
- individë mbi 65 vjeç.
- individë më të rinj se 18 vjeç.
- individë të cilët nuk janë nënshtetas dhe rezident të Republikës të Shqipërisë.

Kufizimet e Sanksioneve dhe Klauzola Përjashtuese

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi ofron mbulim për aq sa mbulimi me sigurim nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo klauzole gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, tregtare ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor."

Periudha e sigurimit

Periudha e sigurimit për çdo të siguruar do të jetë sipas percaktimeve ne formularin e polices te siguirmit, në varësi të përmbushjes së kritereve të marrjes në sigurim, lëshimit të policës dhe pagesës së primeve të duhura në mënyrën dhe afatet kohore të përcaktuara për pagesë.

Në varësi të sa më sipër, mbulimi në sigurim do të fillojë në Datën e Fillimit të sigurimit të përcaktuar në Formularin e policës së sigurimit dhe do të përfundojë në datën më të hershme prej:

- data e perfundimit;
- arritja e moshës 65 vjeç nga i Siguruari;
- ndodhja e ngjarjes së sigurimit.

Territori i mbulimit në sigurim

Sigurimi është i vlefshëm në Shqipëri dhe mbarë botën.

Primi i sigurimit, pagesa e primit

Primi i sigurimit llogaritet dhe paguhet paraprakisht për të gjithë periudhën e sigurimit.

Primi i sigurimit paguhet në llogarinë bankare të SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA.

Nëse primi nuk paguhet si më sipër, atëhere kjo policë nuk ka vlerë dhe mbulimi i dhënë prej saj përfundon prej fillimit (ab initio).

Kontrata

Kontrata e sigurimit përbëhet nga polica bazë dhe çdo përfitim shtesë që i bashkëngjitet, shtojcat dhe kërkesa(t) për sigurim. SIGAL Life mbështetet në kërkesën(at) për sigurim dhe deklarimet e të siguruarit dhe kontraktuesit për të lëshuar këtë policë sigurimi. Të gjithë deklarimet në kërkesën(at) për sigurim konsiderohen si të vërteta për personat që i kanë bërë dhe janë pjesë e kontratës së sigurimit.

Vetëm Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL Life mund të bëjnë ndryshime në këtë policë. Asnjë përfaqësues tjetër i shoqërisë nuk ka kompetencë:

- të ndryshojë këtë policë;
- të heqë dorë nga çdo kërkesë e SIGAL Life;
- të heqë dorë nga çdo përgjigje për ndonjë pyetje në kërkesë.

SIGAL Life nuk do të detyrohet nga ndonjë premtim ose deklarim i bërë nga çdo përfaqësues ose person tjetër përveçse siç përcaktohet më sipër.

Kontrata e sigurimit konsiderohet e nenshkruar nga policembajtesi/i siguruari me pagesen e primit te sigurimit ne llogarine e Siguruaesit. Kryerja e kesaj pagese shpreh vullnetin dhe miratimin e te siguruarit per kete kontrate sigurimi dhe kushtet e pergjithshme te sigurimit

Anullimi

Kjo police mund te anullohet ne baze te kerkeses me shkrim nga i siguruari, te derguar prane Sigal Life ne adresen zyrtare te saj brenda 14 ditesh kalendarike nga data e fillimit te sigurimit. Ne kete rast pagesa e kryer i kthehet te siguruarit ne llogarine e tij prane bankes ku eshte bere pagesa dhe mbulimi i dhënë prej polices përfundon prej fillimit (ab initio).

Rinovimi

Opsioni i rinovimit

Kjo policë ofron sigurim jete me afat deri në datën e përfundimit të përcaktuar në Formularin e policës.

Në se kjo policë është në fuqi, policëmbajtësi mund ta rinovojë për një afat të ri në datën e përfundimit.

Kjo policë ka të drejtë të rinovohet me pagesën e primit te llogaritur për afatin e ri brenda dates 25 te muajit paraardhes te dates te perfundimit. Nuk do të kërkohet dëshmi e sigurueshmërisë dhe nuk do aplikohet periudha e pritjes.

Primet e rinovimit

Primi për çdo afat të ri është primi i rinovimit për moshën që ka arritur i siguruari, në përputhje me tabelën e tarifave të primit të Siguruesit.

Njoftimet dhe deklarimet e të siguruarit/kontraktuesit

Njoftimet dhe deklarimet e të siguruarit dhe kontraktuesit duhet të jenë të plota dhe të mjaftueshme. I siguruari/kontraktuesi duhet t'i japin SIGAL Life çdo informacion që ka lidhje me të siguruarin.

Në se, pas lëshimit të policës së sigurimit, mësohet se i siguruari dhe / ose kontraktuesi kanë paraqitur informacion jo të vërtetë, ose nuk kanë paraqitur informacion thelbësor, SIGAL Life do të ketë të drejtë:

- të kundërshtojë vlefshmërinë e kontratës brenda tre muajve nga data që ka mësuar për pavërtetësinë ose mosparaqitjen e informacionit, duke kryer ndryshime në kushtet e përgjithshme dhe pjesë të tjera të kontratës;
- të anulojë kontratën në rast se nuk do ta kishte lëshuar policën e sigurimit në se do të kishte pasur dijeni për këtë informacion në momentin e lëshimit; të refuzojë pagesën e të ardhurave / përfitimeve.

Mbrojtja dhe perpunimi i te dhenave personale

I siguruari/kontraktuesi është njohur me deklaratën e privatësisë të shoqërisë sigurimeve dhe autorizon Siguruesin që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës të sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e kërkesave për pagesë, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 124/2024 date 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale'') si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Nepermjet lidhjes te kontrates, i siguruari autorizon shoqerine e sigurimit qe per efekt dhe zbatim te kontrates te sigurimit te marre te dhena personale perfshire ato sensitive nga pale te treta me qellim perpunimin e tyre.

E drejta e informimit

I siguruari ka te drejten te informohet nga Siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose perfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nepermjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare ne internet apo broshurave informative te perdoruara nga shoqeria.

I siguruari dhe/ose Policmbajtesi jane informuar nga Siguruesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marre te gjithe informacionin e nevojshëm në lidhje me te dhenat juridike te siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit te kerkesave per demshperblim, rreziqet e mbuluara dhe te perjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe menyra e pageses se primit, metoden e llogaritjes se vleres se kompesueshme dhe cdo informacion tjeter qe ka lidhje me kontraten e sigurimit.

E drejta e te siguruarit per tu ankuar

I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kane te drejte të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, ne rast se cmojne se shoqeria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund te paraqitet ne forme elektronike (e-mail) ose me shkrim ne adresen postare te shoqerise. Shoqëria e sigurimit do ti pergjigjet çdo ankese të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do te jap çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve te percaktuara ne ligj.

Njoftimi i ngjarjes së sigurimit

Me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit Kontraktuesi/Përfituesi duhet të njoftojë Siguruesin në një afat kohor sa më të shkurtër, por brenda 30 ditësh kalendarike nga data e marrjes së njoftimit për ngjarjen, duke specifikuar rrethanat dhe pasojat.

SIGAL Life duhet t'i vihen në dispozicion dokumentacioni vijues për çdo ngjarje sigurimi:

Për 'Humbje Jete për shkaqe natyrale':

- Certifikata e Vdekjes
- Skeda e Vdekjes
- Kopje e policës të sigurimit
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme ku perfshihen por pa u kufizuar:
  - Epikriza mjekësore të lëshuar nga mjeku specialist që ka ndjekur dhe kuruar të siguruarin, ku të përshkruhen me hollësi historiku sëmundjes, koha e diagnostikimit të sëmundjes, shtrimet në spital, trajtimin mjekësor, komplikacionet, sëmundjet e tjera nga i cili vuante i siguruari, kohën, shkaqet e vdekjes etj (firmosur nga mjeku, vulosur nga mjeku dhe institucioni shëndetësor)
  - Dëshminë Noteriale të Trashëgimisë
  - Kopjet e letërnjoftimit të përfituesve (trashëgimtareve ligjorë)
  - Dokument bankar për numrin e llogarisë të përfituesit/ve

Për 'Humbje Jete per shkaqe aksidentale:

- Certifikata e Vdekjes
- Skeda e Vdekjes
- Kopje e policës të sigurimit
- Dokumenta të tjerë mjekësorë/ligjorë nëse është e nevojshme, perfshire por pa u kufizuar:
  - Ekspertimi mjeko-ligjor
  - Vendimi i Prokurorise lidhur me ngjarjen
  - Deshminë Noteriale të Trashëgimisë
  - Kopjet e letërnjoftimit të përfituesve (trashëgimtarëve ligjorë)
  - Dokument bankar për numrin e llogarisë të përfituesit/ve

Përfituesi(t) me shpenzimet e tyre, do t'i paraqesin Siguruesit dokumentet e mësipërme origjinale ose të njehsuara me origjinalin.

Kërkesat për pagesë

Dokumentacioni dhe provat që i duhen paraqitur SIGAL Life përcaktohen më sipër.

Në rastin e kërkesave të vlefshme dhe pas marrjes të "Deklaratës për pranimin e përfitimit të pagueshëm" të nënshkruar siç duhet nga Përfituesi, Siguruesi duhet t'i paguajë Përfituesit Përfitimin e pagueshëm brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e dokumenteve dhe dëshmive të kërkuara.

Përfitimi i pagueshëm paguhet në llogarinë bankare të Përfituesit.

Një pagesë e tillë, kur është bërë, do ta lirojë siguruesin nga çdo detyrim shtesë për përfitimet në fjalë.

Kërkesa për dëmshpërblim/përfitim mashtruese

Nëse ndonjë kërkesë për dëmshpërblim/përfitim sipas kësaj Police do të ketë ndonjë aspekt mashtrimi ose nëse Kontraktuesi, Personi i Siguruar apo çdokush që vepron në emër të tyre do të përdorë mjete mashtrimi, atëhere Siguruesi nuk do të ketë përgjegjësi për kërkesa të tilla.

Subrogimi

Pagesa e përfitimit do të jetë në varësi të kalimit tek SIGAL Life i të gjitha të drejtave të kontraktuesit/përfituesit/të siguruarit ndaj çdo pale të tretë përgjegjëse për ngjarjen e sigurimit, dhe asnjë person ose autoritet nuk do të veprojë për të paragjykuar këto të drejta.

Çdo kërkues pagese sipas kësaj police, me kërkesën e SIGAL Life, do të ndërmarrë dhe do të lejojë të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e të drejtave ndaj çdo pale të tretë në emër të të Siguruarit para dhe/ose pas çdo pagese të kryer nga SIGAL Life.

Juridiksioni

Çdo kundërshti mbi këtë marrëveshje që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok është juridiksion i legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, Gjykata Juridiksionit te Pergjithshem Tirane.